



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA PËRMET

Nr. 627 Prot  
28.02.2020

Përmet, më

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT**

Për: Operatorin ekonomik “Shpresa-AL”shpk

Procedura e prokurimit: *E hapur*

Numri i referencës së procedurës: *REF- 47617-01-17-2020*

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *Lot i I “Blerje naftë (dizel) deri në 10 ppm për nevoja të Bashkisë Përmet dhe institucioneve të varësisë”.*

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): s’ka

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: *çmimi më i ulët X* oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

**Për Lotin e I “Blerje naftë (dizel) deri në 10 ppm për nevoja të Bashkisë Përmet dhe institucioneve të varësisë” kanë dorëzuar në SEP dokumentacionin e ofertës së tyre operatorët si vijon:**

- 1- **Operatori ekonomik Ilvi &Dajana/Flegi shpk** me NIPT L59403201M me marzh fitimi të paraqitur **15 %**
- 2- **Operatori ekonomik “Kastrati”shpk** me NIPT J61813529P me marzh fitimi të paraqitur **7.9 %**
- 3- **Operatori ekonomik “Shpresa-AL”shpk** me NIPT K31321021N me marzh fitimi të paraqitur **30 %**

Nga verifikimi i dokumentacionit përkatës informojmë **operatorët ekonomik të skualifikuar:**

**1. Operatori Ilvi &Dajana/Flegi shpk**

Sheshi “Abdyl Frashëri”, tel.+35581322254, e-mail:info@bashkiapermet.gov.al, www.bashkiapermet.gov.al

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur për ofertën e tyre në sistem (SEP) për këtë procedurë prokurimi, rezulton se ky operator ekonomik nuk i plotëson të gjitha kriteret sipas LPP e RRPP dhe kërkesave të AK në DT të kësaj procedurë prokurimi për arsye se:

Operatorit ekonomik **Ilvi &Dajana/Flegi shpk** nuk ka arritur të paraqesë dokumentacion të plotë dhe të saktë për të dëshmuar plotësimin e të gjithë kërkesave për kualifikim sic kërkohen në shtojcën 9 të DT.

- **Operatori ekonomik Ilvi &Dajana/Flegi shpk** tek Kriteret e veçanta të kualifikimit ka paraqitur Deklaratën e Konfliktit të Interesit (shtojca 7) në të cilën deklaron se nuk ka konflikt interesi. Sipas ekstraktit historik të QKB Administrator është **Z.Flamur Guçe**. Z. Flamur Guçe ushtron njëkohësisht funksionin e anëtarit të Këshillit Bashkiak në Bashkinë Përmet.

Sipas ligjit Nr .9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar neni 21 pika 2 theksohet se: “Kur zyrtari është në funksionin e kryetarit a të nënkryetarit të bashkisë, komunës ose të këshillit të qarkut, të anëtarit të këshillit përkatës ose është zyrtar i nivelit të lartë drejtues të një njësie të qeverisjes vendore, sipas interpretimit të këtij termi në ligjet përkatëse, ndalimi sipas pikës 1 të këtij neni, për shkak të interesave privatë të zyrtarit, të përcaktuara në këtë pikë, zbatohet vetëm në lidhjen e kontratave, sipas rastit, me bashkinë, komunën ose këshillin e qarkut, ku zyrtari ushtron këto funksione. Ky ndalim zbatohet edhe kur palë në kontratë është një institucion publik, në varësi të kësaj njësie.”

- **Operatori ekonomik Ilvi &Dajana/Flegi shpk nuk plotëson pikën 2.2.1 të kapacitetit ekonomik dhe financiar.**

Subjekti ofertues të paraqesë kopje të bilanceve të 3 viteve të fundit (2016, 2017, 2018) nga data e zhvillimit të tenderit të konfirmuara nga organi kompetent, **ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme të mos rezultojnë me humbje** (*Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit*).

**Ky operator i ka dorëzuar bilancet të pa konfirmuara nga organi kompetent.**

Kërkesa për bilancin i shërben anëtrëve të KVO-së për njohjen e gjëndjes financiare të operatorit ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës. Si rrjedhim këto kërkesa u krijojnë mundësinë antarëve të KVO që një operator me bilanc ekonomik negativ është tregues për paaftësinë e këtij operatori ekonomik për përmbushjen e kontratës.

Nga ana tjetër, duke qënë se, bilanci është vetëdeklarim i detyrueshëm i pasqyrave financiare vjetore të tatimpaguesit pranë organeve tatimore, pra ky dokument përgatitet nga vetë tatimpaguesit, është i nevojshëm çertifikimi i tij nga organet tatimore. Në këtë kuptim tatimpaguesi është i detyruar që këtë vetdeklarim, të hartuar në përputhje me ligjin “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” ta depozitojë pranë organeve tatimore brenda datës 31 Mars të vitit pasardhës, i cili çertifikohet nga strukturat përkatëse të administratës tatimore.

Me qëllim paraqitjen e tij si dokumentacion kualifikues, tatimpaguesi duhet të tërheq bilancin e çertifikuar nga administrata tatimore përkatëse. Konfirmimi nga organi tatimor, është një kusht i mundshëm për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë, pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, kundrejt kërkesës që këta të fundit bëjnë në administratën tatimore.

- **Operatori ekonomik Ilvi &Dajana/Flegi shpk nuk plotëson pikën 2.3.2** të paraqesi fletë analizat të lëshuara nga ISHTI për lotin që konkuron e cila duhet të jetë lëshuar brenda 3 muajve nga data e hapjes së ofertave.

Fletë analiza është kërkuar për të krijuar bindjen e AK Bashkia Përmet se malli për të cilën do të furnizohet është në përputhje me standartet e vendosura nga Inspektoriati Shtetëror Teknik Industrial.

Inspektoriati Shtetëror Teknik Industrial ushtron inspektime në fushën e përpunimit, transportimit dhe tregëtimit të naftës dhe gazit dhe nënprodukteve të tyre , e garantimit të sigurisë së njerëzve dhe vlerave materiale nga rreziqet e shfryrjeve dhe shpërthimeve të shkaktuara nga paisjet nën presion, si dhe nga paisjet dhe instalimet elektrike, si dhe ushtron funksionin e tij rregullator në përputhje me nevojat e vendit, të mbrojtjes kombëtare dhe të sigurimit publik duke respektuar parimet e ekonomisë së tregut.

Ky kriter është vendosur në përputhje të ligjit nr.8450 datë 24.02.1999 "Për përpunimin, transportimin dhe tregëtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre" indryshuar.

Neni 23 Inspektoriati Shtetëror Përgjegjës

1.Organi shtetëror, i specializuar për kontrollin e veprimtarisë së personave juridikë, të ushtruar në përputhje me dispozitat e këtij ligji, është Inspektoriati Shtetëror Përgjegjës , që funksionon dhe varet nga ministri përgjegjës për hidrokarburet.Ky inspektoriat mbështetet në kryerjen r funksioneve të tij nga laboratorë të akredituar për fushën dhe testet përkatëse. Këta laboratorë mund të jenë pjesë e këtij inspektoriati ose jashtë tij. Për çdo rast testimi, duhet të ruhet fshehtësia e mostrës".

- **Operatori ekonomik Ilvi &Dajana/Flegi shpk nuk plotëson pikën 2.3.3** të jetë i pajisur me leje tregtimi me pakicë të lëndëve djegëse Karburante ose Licencë për tregëtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm naftës për automjete,vajrave lubrifikant.

Ky kriter është kërkuar në përputhje me ligjin nr.8450 datë 24.02.1999 "Për përpunimin , për transportimin dhe tregëtimin e naftës , të gazit dhe nënprodukteve të tyre" kreu II " Proçedura për dhënien e licensave për tregëtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës , për automjetet, vajrave lubrifikant dhe lëndëve djegëse për përdorimin nga konsumatorët fundor"

Veprimtaria e tregëtimit me shumicë të naftës bruto dhe nënprodukteve të saj bëhet vetëm nga shoqëritë tregëtare, të themeluara në formën e shoqërisë aksionere , pasi të jenë pajisur me "Licencë tregëtimi" nga Qendra Kombëtare e Licencimit ( QKL).

Në nenin 46, pika 1, gërma "b" të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: "Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, **pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese**".

a) kualifikimi profesional: çdo operatori ekonomik i kërkon licencat profesionale, industriale

apo tregtare, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore, për veprimtaritë e kërkuara dhe për të cilat do të lidhet kontrata;

b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;

c) gjendja ekonomike e financiare: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet ekonomike e financiare për të përmbushur kontratën, me anë të deklaratave bankare ose, kur nevojitet, nëpërmjet vërtetimit për sigurim ndaj rreziqeve profesionale, paraqitjes së bilanceve financiare ose të pjesëve të shkëputura nga bilancet, një deklaratë të xhiros së përgjithshme të shoqërisë dhe, në rast nevoje, të xhiros së realizuar nga veprimtaritë e ngjashme me objektin e kontratës që do të prokurohet për një periudhë deri në 3 vitet e fundit financiare, kur ky informacion është i mundur;

ç) kapacitetet ligjore: operatorët ekonomikë vërtetojnë se ata kanë zotësi juridike për të lidhur kontrata prokurimi ose, në rastet e bashkimit të shoqërive, vërtetojnë se i gëzojnë këto aftësi në kohën e lidhjes së kontratës.

Neni 53 pika 3 e Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet shprehimisht se: Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji.

## 2. Operatori ekonomik “Kastrati”shpk

Nga verifikimi në SPE (sistemin e prokurimeve elektronike) të dokumentacionit të dorëzuar nga ky operator ekonomik rezulton se në përmbushje të kriterëve të përcaktuara në dokumentat e tenderit “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, “Kapaciteti ekonomik dhe financiar”, nga operatori ekonomik është paraqitur:

1. Vërtetim me nr. 26 prot datë 26.06.2019, sipas së cilës shoqëria ka paguar detyrimet e taksave vendore për vitin 2019 në **Bashkinë Mirditë** me adresë Rëshen.
2. Vërtetim me nr. 6808 prot datë 02.07.2019, sipas së cilës shoqëria ka paguar detyrimet e taksave vendore për vitin 2019 në **Bashkinë Lezhë**.
3. Vërtetim me nr. 2459 prot datë 17.09.2019, sipas së cilës shoqëria ka paguar detyrimet e taksave vendore për vitin 2019 në **Bashkinë Ura Vajgurore**.
4. Vërtetim me nr. 15 prot datë 25.06.2019, sipas së cilës shoqëria ka paguar detyrimet e taksave vendore për vitin 2019 në **Bashkinë Dibër**.
5. Vërtetim datë 25.06.2019, sipas së cilës shoqëria ka paguar detyrimet e taksave vendore për vitin 2019 në Njësinë Administrative Gostime, **Bashkia Cërrik**.
6. Vërtetim me nr.4189 prot datë 16.05.2019, sipas së cilës shoqëria ka paguar detyrimet e taksave vendore për vitin 2019 në **Bashkinë Vlorë**.
7. Vërtetim datë 25.06.2019, sipas së cilës shoqëria ka paguar detyrimet e taksave vendore për vitin 2019 në **Bashkinë Përrenjas**.
8. Vërtetim me nr.41 prot datë 25.06.2019 , sipas së cilës shoqëria ka paguar detyrimet e taksave vendore për vitin 2019 në **Bashkinë Kavajë** me adresë Golem - Kavajë, hyrje e qytetit Kavajë,

Lagjia nr 2, godinë 1-katëshe .

9. Vërtetim me nr.1577/1 prot datë 25.06.2019, sipas së cilës shoqëria ka paguar detyrimet e taksave vendore për vitin 2019 në **Bashkinë Përmet**.

10. Vërtetim me nr.4699 prot datë 25.06.2019 , sipas së cilës shoqëria ka paguar detyrimet e taksave vendore për vitin 2019 në **Bashkinë Korçë** me adresë Korçë - Tiranë KM 1, përballë Hotel Konti.

11. Vërtetim datë 17.09.2019, sipas së cilës shoqëria ka paguar detyrimet e taksave vendore për vitin 2019 në **Bashkinë Devoll**.

12. Vërtetim me nr.2340 prot datë 18.09.2019 , sipas së cilës shoqëria ka paguar detyrimet e taksave vendore për vitin 2019 në **Bashkinë Delvinë** me adresë Fshati Stjar.

13. Vërtetim me nr.1232 prot datë 17.09.2019 , sipas së cilës shoqëria ka paguar detyrimet e taksave vendore për vitin 2019 në **Bashkinë Tepelenë**.

14. Vërtetim me nr.452 prot datë 25.06.2019, sipas së cilës shoqëria ka paguar detyrimet e taksave vendore për vitin 2019 në **Bashkinë Gjirokastrë** me adresë Lagjia “11 Janari”.

15. Vërtetim datë 19.09.2019 , sipas së cilës shoqëria ka paguar detyrimet e taksave vendore për vitin 2019 në **Bashkinë Shijak**.

16. Vërtetim me nr.K-9229/1 prot datë 26.06.2019, sipas së cilës shoqëria ka paguar detyrimet e taksave vendore për vitin 2019 në **Bashkinë Tiranë** me adresë Bulevardi “Barjam Curri”, zona kadastrale 8260 nr. pasurie 1/404 Ndertesë 1.

17. Vërtetim me nr.3764 prot datë 10.07.2019 , sipas së cilës shoqëria ka paguar detyrimet e taksave vendore për vitin 2019 në **Bashkinë Librazhd**.

18. Vërtetim datë 20.05.2019, sipas së cilës shoqëria ka paguar detyrimet e taksave vendore për vitin 2019 në **Bashkinë Durrës** me adresë Lagjia 14, Shkozë Durrës.

19. Vërtetim datë 12.07.2019, sipas së cilës shoqëria ka paguar detyrimet e taksave vendore për vitin 2019 në **Bashkinë Pukë**.

20. Vërtetim datë 25.06.2019, sipas së cilës shoqëria ka paguar detyrimet e taksave vendore për vitin 2019 në **Bashkinë Kurbin**.

21. Vërtetim me nr.694 prot datë 09.07.2019 , sipas së cilës shoqëria ka paguar detyrimet e taksave vendore për vitin 2019 në Njësinë Administrative Bradashesh, **Bashkia Elbasan**.

22. Vërtetim me nr.1136/1 prot datë 18.09.2019 , sipas së cilës shoqëria ka paguar detyrimet e taksave vendore për vitin 2019 në **Bashkinë Mallakastër**.

23. Vërtetim me nr.271 prot datë 21.06.2019 , sipas së cilës shoqëria ka paguar detyrimet e taksave vendore për vitin 2019 në **Bashkinë Vorë**.

24. Vërtetim me nr.518 prot datë 19.06.2019, sipas së cilës shoqëria ka paguar detyrimet e taksave vendore për vitin 2019 në **Bashkinë Fier** me adresë Lagjia “Kryengritja e Fierit”.

25. Vërtetim me nr.30/18 prot datë 18.09.2019 , sipas së cilës shoqëria ka paguar detyrimet e taksave vendore për vitin 2019 në **Bashkinë Sarandë**.

26. Vërtetim me nr.235 prot datë 25.06.2019, sipas së cilës shoqëria ka paguar detyrimet e taksave vendore për vitin 2019 në **Bashkinë Shkodër** me adresë Rruga “Gjovalin Gjadri”.

27. Vërtetim me nr.5502 prot datë 25.06.2019, sipas së cilës shoqëria ka paguar detyrimet e taksave vendore për vitin 2019 në **Bashkinë Lushnjë** me adresë Lagjia “Çlirim” ngjitur me zyrat e QTT Bujqësore.

28. Vërtetim me nr.221 prot datë 18.09.2019, sipas së cilës shoqëria ka paguar detyrimet e taksave vendore për vitin 2019 në **Bashkinë Kamëz** me adresë Bulevardi “Blu”.

29. Vërtetim datë 17.09.2019, sipas së cilës shoqëria ka paguar detyrimet e taksave vendore për vitin 2019 në **Bashkinë Krujë**.

30. Vërtetim datë 25.06.2019, sipas së cilës shoqëria ka paguar detyrimet e taksave vendore për vitin 2019 në Njësinë Administrative Otlak, **Bashkia Berat**.

31. Vërtetim me nr.2095 prot datë 26.06.2019, sipas së cilës shoqëria ka paguar detyrimet e taksave vendore për vitin 2019 në **Bashkinë Kukës** me adresë Lagjia Nr.3.

#### **Bazuar në pikën 2.3.4 të kapacitetit ekonomik e financiar:**

***Operatori ekonomik duhet të paraqesë listën e stacioneve të shitjes së karburanteve me pakicë*** në qytetin e Përmetit (minimumi 1), vërtetuar me një nga format e disponimit sipas Kodit Civil (kontratë noteriale ose akt pronësie ose të jenë të pasqyruara në ekstraktin e QKR,etj) për këto stacione.

Ky operator ka deklaruar në listën e paraqitur në sitemin SPE se **përmban 80 adresa distributori të shitjes me pakicë të karburanteve** në qytete të ndryshme.

Bazuar në pikën 2.2.3 të kapacitetit ekonomik dhe financiar operatori ekonomik duhet të paraqesi një dokument që vërteton se ka plotësuar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2019, referuar ligjit nr.9632 datë 30.10.2006 “ Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, **në të gjitha njësitë e qeverisjes vendore ku operatori ekonomik ka selinë dhe ku ka zhvilluar apo zhvillon veprimtarinë e tij ( sipas ekstraktit të thjeshtë dhe historik të operatorit ekonomik lëshuar nga QKB).**

**Në Bashkinë Tiranë** ky operator ka deklaruar 15 adresa për shitje karburanti. Ka paraqitur vetëm vërtetimin me nr.K-9229/1 prot datë 26.06.2019, sipas së cilës shoqëria ka paguar detyrimet e taksave vendore për vitin 2019 në Tiranë me adresë specifike Bulevardi “Barjam Curri”, zona kadastrale 8260 nr. pasurie 1/404 Ndertesa 1. Kjo adresë e specifikuar nuk korrespondon me asnjë nga adresat e deklaruara për shlyerjen taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Tiranë. ***Mungojnë vërtetimet për adresat e tjera specifike.***

**Në Bashkinë Kamëz** ky operator ka deklaruar 2 adresa të ushtrimit të aktivitetit. Ka paraqitur vetëm vërtetimin me nr.221 prot datë 18.09.2019, sipas së cilës shoqëria ka paguar detyrimet e taksave vendore për vitin 2019 në Bashkinë Kamëz me adresë specifike Bulevardi “Blu”. ***Mungon vërtetimi për adresën tjetër.***

**Në Bashkinë Durrës** ky operator ka deklaruar 12 adresa për shitje karburanti. Ka paraqitur vetëm vërtetimin me datë 20.05.2019, sipas së cilës shoqëria ka paguar detyrimet e taksave vendore për vitin 2019 në Bashkinë Durrës me adresë specifike Lagjia 14, Shkozet Durrës. ***Mungojnë vërtetimet për 11 adresat e tjera të ushtrimit të aktivitetit.***

**Në Bashkinë Shkodër** ky operator ka deklaruar 3 adresa për shitje karburanti. Ka paraqitur vetëm vërtetimin me nr.235 prot datë 25.06.2019, sipas së cilës shoqëria ka paguar detyrimet e taksave vendore për vitin 2019 në Bashkinë Shkodër me adresë Rruga “Gjovalin Gjadri”. ***Mungon vërtetimi për 2 adresat e tjera.***

**Në Bashkinë Kavajë** ky operator ka deklaruar 4 adresa për shitje karburanti. Ka paraqitur vetëm vërtetimin me nr.41 prot datë 25.06.2019 , sipas së cilës shoqëria ka paguar detyrimet e taksave vendore për vitin 2019 në Bashkinë Kavajë me adresë Golem - Kavajë, hyrje e qytetit Kavajë, Lagjia nr 2, godinë 1-katëshe. Mungon vërtetimi për 3 adresat e tjera.

Në **Bashkinë Lushnjë** ky operator ka deklaruar 3 adresa për shitje karburanti. Ka parqitur vetëm vërtetimin me nr.5502 prot datë 25.06.2019, sipas së cilës shoqëria ka paguar detyrimet e taksave vendore për vitin 2019 në Bashkinë Lushnjë me adresë Lagjia “Çlirim” ngjitur me zyrat e QTT Bujqësore. **Mungon vërtetimi për 2 adresat e tjera.**

Në **Bashkinë Fier** ky operator ka deklaruar 2 adresa për shitje karburanti. Ka parqitur vetëm vërtetimin nr.518 prot datë 19.06.2019, sipas së cilës shoqëria ka paguar detyrimet e taksave vendore për vitin 2019 në Bashkinë Fier me adresë Lagjia “Kryengritja e Fierit”. **Mungon vërtetimi për adresën tjetër.**

Në **Bashkinë Gjirokastrë** ky operator ka deklaruar 2 adresa për shitje karburanti. Ka parqitur vetëm vërtetimin nr.452 prot datë 25.06.2019, sipas së cilës shoqëria ka paguar detyrimet e taksave vendore për vitin 2019 në Bashkinë Gjirokastrë me adresë Lagjia “11 Janari”. **Adresat e deklarura nuk janë ato për të cilën ka paraqitur vërtetimin.**

Në **Bashkinë Korçë** ky operator ka deklaruar 2 adresa për shitje karburanti. Ka parqitur vetëm vërtetimin me nr.4699 prot datë 25.06.2019 , sipas së cilës shoqëria ka paguar detyrimet e taksave vendore për vitin 2019 në Bashkinë Korçë me adresë Korçë - Tiranë KM 1, përballë Hotel Konti. **Mungon vërtetimi për adresën tjetër.**

Në **Bashkinë Elbasan** ky operator ka deklaruar 4 adresa për shitje karburanti. Ka parqitur vetëm vërtetimin me nr.694 prot datë 09.07.2019 , sipas së cilës shoqëria ka paguar detyrimet e taksave vendore për vitin 2019 në Njësinë Administrative Bradashesh, Bashkia Elbasan. **Mungojnë vërtetimet për 3 adresat e tjera.**

Në **Bashkinë Mirditë** ky operator ka deklaruar 2 adresa për shitje karburanti. Ka parqitur vetëm vërtetimin me nr. 26 prot datë 26.06.2019, sipas së cilës shoqëria ka paguar detyrimet e taksave vendore për vitin 2019 në Bashkinë Mirditë me adresë Rëshen. **Mungon vërtetimi për adresën tjetër.**

Në nenin 46, pika 1, gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, **pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese**”. Aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës”.

Neni 53 pika 3 e Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet shprehimisht se: Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji.

Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

Referuar sa më sipër KVO konstaton se në kriterin e vecantë të kualifikimit autoriteti kontraktor ka kërkuar nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës të dorëzojnë vërtetim për shlyerjen e taksave vendore për vitin 2019 për cdo vendndodhje ku ushtron biznes. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik "Kastrati" shpk në përmbushje të këtij kriteri ky i fundit ka dorëzuar vërtetime 2019 vetëm për disa nga adresat ku ushtron aktivitet sipas ekstraktit historik dhe listës së distributorëve të shitjes me pakicë të karburanteve të deklaruar nga vet operatori.

### **Oferta te kualifikuara:**

#### **- Operatori ekonomik "Shpresa-AL" shpk**

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur për ofertën e tij në sistem (SEP) për këtë procedurë prokurimi, rezulton se **Operatori Ekonomik "Shpresa-AL" shpk**, plotëson kriteret e kushteve të përgjithshme, kushteve të veçanta, kërkesat e dokumentacionit të përgjithshëm administrativ, ligjor, teknik dhe ekonomik, sipas kërkesave të AK në njoftimin e kontratës dhe DT të kësaj procedurë prokurimi.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **Operatorin ekonomik "SHPRESA-AL" shpk** me adresë *Njësia Bashkiake Nr.9 rruga "Urani Pano", mbrapa "Veve Center" Pallati nr. 11 kati 2 TIRANË* se oferta e paraqitur, me një **marzh fitimi 30 %(tridhjetë përqind)** është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë *Bashkisë Përmet me adresë Sheshi "Abdyl Frashëri" kati i katërt Zyra Juridike*, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës do te veprohet siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.

**Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 20.02.2020**

**Ankesa: JO**

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR**

**Alma HOXHA**

Sheshi "Abdyl Frashëri", tel.+35581322254, e-mail:info@bashkiapermet.gov.al, www.bashkiapermet.gov.al